



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORE  
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS  
NR. 611/38 PROT.  
DATA 06 10 2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINSTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. \_\_\_\_ prot.

Dt. /07/2022

MEMORANDUM MIRËKUPtimi MBI FUNKSIONIMIN E RRJETIT TË  
QENDRAVE TË TË NXËNIT GJATË GJITHË JETËS TË NGRITURA NË TETË  
UNIVERSITETE SHQIPTARE NË KAUDËR TË PROJEKTIT  
"ENTREPRENEURIAL SKILLS FOR A MODERN EDUCATION IN ALBANIA"

**EntrAL**

**NDËRMJET**

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE, TIRANË  
UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR  
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS  
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR XIUVANI", ELBASAN  
UNIVERSITETIT "FAN.S.NOLI", KORÇË  
UNIVERSITETIT "EQEREM ÇABEJ", GJIROKASTËR  
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE  
KU "PAVARËSIA", VLORE  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR

Edukimi për sipërmarrjen aktualisht po promovohet fuqishëm në shumicën e vendeve evropiane dhe më gjerë. Kjo kompetencë ka zënë një vend të rëndësishëm dhe është ridimensionuar në politikat e sotme arsimore të BE-së dhe si rrjedhojë është shfaqur roli i individit për të kryer sipërmarrjen për vete dhe për shoqërinë, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së të gjithë shoqërisë. Në kuadrin e vendit tonë, edukimi për sipërmarrjen si një objektiv strategjik për arsimin dhe ekonominë, krijon premisat për të nxitur frymën e iniciativës dhe inovacionit, punësimit dhe vetëpunësimit, orientimit në punë dhe edukimit të rinjve duke iu referuar zhvillimeve dhe perspektivave aktuale në tregun e punës.

Bazuar në projektin “Entrepreneurial skills for a modern education in Albania” (EntrAL) (ERASMUS+) dhe pikërisht në pikën 3.3. “Krijimi i rrjetit shqiptar të qendrave për sipërmarrjen”, në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026, Udhëzim nr.16, datë 28.07.2021, “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”; në Standardet profesionale të mësuesit, tetë universitetet e përfshira në këtë projekt Universiteti i Sporteve, Tiranë, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë, Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, KU “Pavarësia”, Vlorë dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, të cilat përgatisin dhe zbatojnë politikat e zhvillimit profesional të mësuesve në fushat e aktivitetit të tyre, kanë rënë dakord mbi termat dhe kushtet si më poshtë:

## **Neni 1** **Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është koordinimi ndërinstitucional për zhvillimin profesional të mësuesve, studentëve dhe stafit akademik në sistemin e arsimit parauniversitar dhe në sistemin e arsimit të lartë, nëpërmjet realizimit të trajnimeve të mësuesve sipas moduleve të akredituara nga Komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit (KAPT), trajnimit të studentëve dhe stafit akademik të arsimit të lartë sipas moduleve të hartuara nga ky rrjet.

## **Neni 2** **Objektivat**

Objektivat kryesore të Memorandumit janë:

- a) Hartimi i moduleve të trajnimit për sipërmarrjen:
  - në përputhje me nevojat dhe kërkesat e mësuesve në arsimin parauniversitar të identifikuar në kuadër të këtij projekti;

- në përputhje me nevojat dhe kërkesat e stafit akademik në arsimin e lartë të identifikkuara në kuadër të këtij projekti;
  - në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve në arsimin e lartë të identifikkuara në kuadër të këtij projekti;
- b) Akreditimi i moduleve të trajnimit të mësuesve të hartuara nga institucionet e arsimit të lartë të përfshira në këtë projekt;
- c) Ofrimi i moduleve për studentët, stafin akademik të arsimit të lartë dhe mësuesve të arsimit parauniversitar nga qendrat e trajnimit të të nxënit gjatë gjithë jetës të ngritura pranë institucioneve të arsimit të lartë të përfshira në këtë projekt.

### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Marrëveshja hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj datë 31/07/2022 deri në përfundim të projektit EntrAL (Erasmus +), 31/07/2024 dhe do të zbatohet në qendrat e të nxënit gjatë gjithë jetës për trajnimin e mësuesve në institucionet: Universiteti i Sporteve, Tiranë, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë, Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastër, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, KU “Pavarësia”, Vlorë.

### **Neni 4**

#### **Përgjegjësitë e institucioneve**

##### **4.1 Institucionet e arsimit të lartë**

Institucionet e arsimit të lartë marrin përsipër:

- të sigurojnë funksionimin e rrjetit të qendrave të të nxënit gjatë gjithë jetës për trajnimin e studentëve dhe stafit akademik të arsimit të lartë si dhe të mësuesve të arsimit parauniversitar;
- të hartojnë module trajnimi sipas fushave në përputhje me nevojat e studentëve, të stafit akademik dhe të mësuesve;
- të sigurojnë zhvillimin e moduleve për sipërmarrjen me studentët dhe me stafin akademik të arsimit të lartë;
- të sigurojnë trajnime për sipërmarrjen me mësuesit në arsimin parauniversitar në përputhje me nevojat dhe interesat e mësuesve dhe moduleve të trajnimit të akredituara;
- të koordinojnë funksionimin e rrjetit të qendrave të të nxënit gjatë gjithë jetës për trajnimin e mësuesve ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë;

- të zbatojnë legjislacionin përkatës për organizimin e trajnimeve të mësuesve;
- të vënë në dispozicion mjediset e qendrave të të nxënit gjatë gjithë jetës për trajnimin e mësuesve;
- të certifikojnë mësuesit në përfundim të trajnimeve për modulet e trajnimit të akredituara.

#### **4.2 Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)**

ASCAP merr përsipër:

- të mbështesë institucionet e arsimit të lartë të përfshira në projektin EntrAL për funksionimin e rrjetit të qendrave të të nxënit gjatë gjithë jetës për trajnimin e mësuesve;
- të mbështesë institucionet e arsimit të lartë të përfshira në projektin EntrAL për akreditimin e moduleve të trajnimit të hartuara në kuadër të këtij projekti;
- të sigurojnë regjistrimin e institucioneve të arsimit lartë në portalin e trajnimeve të mësuesve;
- të mbështesë institucionet e arsimit të lartë me materialet e zbatimit të kurrikulës si dhe me materiale të tjera të hartuara nga ASCAP për zhvillimin profesional të mësuesve në arsimin parauniversitar.

### **Neni 5**

#### **Përfaqësimi i institucioneve**

Institucionet nënshkruese të këtij Memorandumi vendosin që Memorandumi të mbikqyret nga drejtuesit e institucioneve të përcaktuara si më poshtë:

- Universiteti i Sporteve, Tiranë, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë, Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, KU “Pavarësia”, Vlorë (*Rektorët përkatës*);
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (*Drejtori i përgjithshëm*).

### **Neni 6**



















#### **Dispozita përfundimtare**

Institucionet kanë të drejtë të negociojnë ndryshime ose amendamente të elementëve të këtij Memorandumi. Ky Memorandum mund të ndryshohet nga institucionet vetëm me shkrim.

Nëse pas datës së nënshkrimit të këtij Memorandumi miratohen akte ligjore/nënligjore që ndryshojnë ose ndikojnë në kushtet e këtij Memorandumi, ato do të jenë objekt i

shtesave/amendimeve me shkrim për aq sa institucionet ndikohen në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas këtij Memorandumi.

Ky Memorandum është nënshkruar sot në datë \_\_\_/07/ 2022, në 9 kopje të barasvlershme.

Universiteti i Sporteve, Tiranë	Rektor:		Firma:	
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	Rektor:		Firma:	
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	Rektor:		Firma:	
Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan	Rektor:		Firma:	
Universiteti "Fan.S.Noli", Korçë	Rektor:		Firma:	
Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastrër	Rektor:		Firma:	
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	Rektor:		Firma:	
KU "Pavarësia", Vlorë	Rektor:		Firma:	
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar	Drejtor: Gerti JANAQI		Firma:	



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRY OF EDUCATION AND SPORTS

**ENGLISH VERSION**

(only the Albanian version was signed; this document is for clarification)

Nr. \_\_\_\_ prot.

DATE .....2022

**MEMORANDUM OF UNDERSTANDING ON THE OPERATION OF THE  
NETWORK OF LIFELONG LEARNING CENTERS ESTABLISHED IN  
EIGHT ALBANIAN UNIVERSITIES DURING THE PROJECT  
"ENTREPRENEURIAL SKILLS FOR A MODERN EDUCATION IN  
ALBANIA"**

**EntrAL**

**Between**

**UNIVERSITY OF SPORTS, TIRANA  
"LUIGJ GURAKUQI" UNIVERSITY, SHKODER  
"ALEKSANDR MOISIU" UNIVERSITY, DURRES  
"ALEKSANDR XHUVANI" UNIVERSITY, ELBASAN  
"FAN.S.NOLI" UNIVERSITY, KORÇE  
"EQEREM CABEJ" UNIVERSITY, GJIROKASTER  
"ISMAIL QEMALI" UNIVERSITY, VLORE  
UNIVERSITY COLLEGE "INDEPENDENCE", VLORE  
PRE-UNIVERSITY EDUCATION QUALITY ASSURANCE AGENCY**

Entrepreneurship education is currently being strongly promoted in most European countries and beyond. This competence has taken an important place and has been re-dimensioned in today's educational policies of the EU and as a result the role of the individual has appeared to carry out entrepreneurship for himself and for society, directly influencing the quality of life of the whole society. In the framework of our country, entrepreneurship education as a strategic objective for education and the economy creates the premises to encourage the spirit of initiative and innovation, employment and self-employment, job orientation and youth education referring to current developments and perspectives in the market of work.

Based on the project "Entrepreneurial skills for a modern education in Albania" (EntrAL) (ERASMUS+) and precisely in point 3.3. "Creation of the Albanian network of centers for entrepreneurship", in law no. 80/2015 "On higher education and scientific research in higher education institutions in the Republic of Albania", in law no. 69/2012 dated 21.06.2012 "On Pre-university education in the Republic of Albania", amended; in the Pre-University Education Development Strategy 2021-2026, Instruction No. 16, dated 28.07.2021, "On the operation of the system of continuous professional development of educational employees"; in Teacher Professional Standards, the eight universities involved in this project: University of Sports, Tirana, "Luigj Gurakuqi" University, Shkodër, "Aleksandër Moisiu" University, Durrës, "Aleksandër Xhuvani" University, Elbasan, "Fan.S. Noli" University, Korçë, "Eqerem Çabej" University, Gjirokastër, "Ismail Qemali" University, Vlorë, KU "Pavarësia", Vlorë and the Quality Assurance Agency of Pre-University Education, which prepare and implement the professional development policies of teachers in the fields of activity have agreed on the following terms and conditions:

### **Article 1 Purpose**

The purpose of this Memorandum is the inter-institutional coordination for the professional development of teachers, students and academic staff in the pre-university education system and in the higher education system, through the realization of teacher trainings according to the modules accredited by the Commission for the accreditation of training programs/modules (KAPT), the training of students and academic staff of higher education according to the modules designed by this network.

### **Article 2 Objectives**

The main objectives of the Memorandum are:

a) Designing training modules for entrepreneurship:

- in accordance with the needs and requirements of teachers in pre-university education identified within this project;
- in accordance with the needs and requirements of the academic staff in higher education identified within this project;
- in accordance with the needs and demands of students in higher education identified within this project;
  - a) Accreditation of teacher training modules designed by higher education institutions included in this project;
  - b) Providing modules to students, academic staff of higher education and teachers of pre-university education from lifelong learning training centers set up near higher education institutions involved in this project.

### **Article 3 Duration of the Agreement**

The agreement enters into force from the date of its signature date ..... until the end of the EntrAL (Erasmus +) project, ..... .. and will be implemented in lifelong learning centers for teacher training in institutions: University of Sports, Tirana, "Luigj Gurakuqi" University Shkodër, "Aleksandër Moisiu" University, Durrës, "Aleksandër Xhuvani" University, Elbasan, "Fan.S. Noli" University, Korçë, "Eqerem Çabej" University, Gjirokastër, "Ismail Qemali" University, Vlorë, KU "Pavarësia", Vlorë.

### **Article 4 Responsibilities of institutions**

#### 4.1 Institutions of higher education

Higher education institutions undertake:

- to ensure the functioning of the network of lifelong learning centers for the training of students and academic staff of higher education as well as pre-university education teachers;
- design training modules according to the fields in accordance with the needs of students, academic staff and teachers;
- ensure the development of modules for entrepreneurship with students and academic staff of higher education;
- provide entrepreneurship training with teachers in pre-university education in accordance with the needs and interests of teachers and accredited training modules;
- to coordinate the operation of the network of lifelong learning centers for teacher training between higher education institutions;
- to implement the relevant legislation for the organization of teacher trainings;
- make available the facilities of lifelong learning centers for teacher training;
- to certify the teachers at the end of the training for the accredited training modules.

#### 4.2 Agency for Quality Assurance of Pre-University Education (ASCAP)

ASCAP undertakes:

- to support higher education institutions involved in the EntrAL project for the operation of the network of lifelong learning centers for teacher training;



- to support the institutions of higher education included in the EntrAL project for the accreditation of the training modules designed within this project;
- ensure the registration of higher education institutions in the teacher training portal;
- to support higher education institutions with curriculum implementation materials as well as other materials designed by ASCAP for the professional development of teachers in pre-university education.

### **Article 5 Representation of institutions**

The signatory institutions of this Memorandum decide that the Memorandum will be supervised by the heads of the institutions defined as follows:

- University of Sports, Tirana,
- "Luigj Gurakuqi" University, Shkodër,
- "Aleksandër Moisiu" University, Durrës,
- "Aleksandër Xhuvani" University, Elbasan,
- "Fan.S.Noli" University, Korçë,
- "Eqerem Çabej" University, Gjirokastrë,
- University "Ismail Qemali", Vlorë,
- University College "Pavarësia", Vlorë (relevant Rectors);
- Agency for Quality Assurance of Pre-University Education (General Director).

### **Article 6 Final provision**

Institutions have the right to negotiate changes or amendments to the elements of this Memorandum. This Memorandum can be changed by the institutions only in writing.

If, after the date of signing this Memorandum, legal/sub-legal acts are approved that change or affect the terms of this Memorandum, they will be subject to written additions/amendments as far as the institutions are affected in fulfilling their obligations under this Memorandum.

This Memorandum was signed today on \_\_\_/\_\_\_/2022, in 9 equivalent copies.

University of Sports, Tiranë

Rektor:

Firma:

University "Luigj Gurakuqi", Shkodër

Rektor:

Firma:

University "Aleksandër Moisiu", Durrës

Rektor:

Firma:

University "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

Rektor:

Firma:

University "Fan.S.Noli", Korçë

Rektor:

Firma:

University "Eqerem Çabej", Gjirokastrë

Rektor:

Firma:

University "Ismail Qemali", Vlorë

Rektor:

Firma:

University College "Pavarësia", Vlorë

Rektor:

Firma:

Agency for Quality Assurance of Pre-University Education

Director:

Firma: